



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**ENTI RREGULLATOR I SEKTORIT TË FURNIZIMIT ME UJË DHE
LARGIMIT E PËRPUNIMIT TË UJËRAVE TË NDOTURA**

VENDIM

Nr. 21, datë 03.06.2015

**MBI TARIFAT E UJIT PËR KONSUM PUBLIK PËR SHOQËRINË U
KORÇË FSHAT SH.A.**

Në mbështetje të nenit 14 dhe 21, të ligjit nr. 8102, datë 28.03.1996 "Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujrave të ndotura", i ndryshuar, Metodologjisë "Për vendosjen e tarifave", si dhe vendimit të KKRR nr. 22, datë 14.11.2014 "Për miratimin e përqindjes së pagesës rregullatore për vitin 2015", Komisioni Kombëtar Rregullator

VENDOSI:

1. Miratimin e tarifave për shoqërinë U Korcë Fshat Sha :

a. Tarifë volumetrike për shërbimin e furnizimit me ujë:

Shërbim i matur

Konsumator familjar	38 lek/m ³
Institucione buxhetore	90 lek/m ³
Ente private	95 lek/m ³

Shërbim i pamatur

Konsumator familjar	400 lek/muaj/klient
---------------------	---------------------

b. Tarifë fikse

Konsumator familjar	50 lek/muaj/klient
Institucione buxhetore	50 lek/muaj/klient
Ente private	50 lek/muaj/klient

2. Objektivat e Treguesve Kryesorë të Performancës për vitin 2015:

➤ uji pa të ardhura (humbjet)	29 %
➤ niveli i matjes	67 %
➤ kohëzgjatja e furnizimi	13 orë/ditë
➤ eficaenca e energjise	1.2 kwh/m ³
➤ efikasiteti i stafit	7.8 p/000/lidhje
➤ mbulimi me ujë	66%

- norma e arketimit 94 %
- cilësia e ujit (klor+koliform) sipas standarteve

3. Pagesa rregullatore vjetore për fshat Sha U Korçë Fshat do të jetë 0.6% e të ardhurave të llogaritura.

4. Ky vendim hyn në fuqi më 01.07.2015 dhe është i vlefshëm deri në miratimin e tarifave të reja.

KRYETARI
Avni Dervishi